



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2022

VENDIM

Nr. 38, datë 28.01.2022

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE TË SKEMËS SË DELEGIMIT, PËR GJYKIMIN E
DY ÇËSHTJEJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR
KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr. 63 prot., datë 26.01.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 525 prot., datë 26.01.2022, dhe asaj me shkresën nr. 520/1 prot., datë 29.12.2021, protokolluar në Këshill me nr. 5927 prot., datë 31.12.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...} dhe {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 298/3, 333/a/2, 334 të Kodit Penal”.
2. Gjyqtarët e skemës së delegimit z. Engert Pëllumbi dhe znj. Igerta Hysi caktohen për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 259-25 të Kodit Penal”.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarëve z. Florjan Kalaja, z. Engert Pëllumbi, dhe znj. Igerta Hysi sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR